

## **Fortlumtura e Tij, Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Imzot Joan, vijoi vizitën e tij zyrtare në Patriarkanën Ekumenike**



Të dielën, më 15 qershor 2025, Fortlumtura e Tij, Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Imzot Joan, vijoi vizitën e tij zyrtare në Patriarkanën Ekumenike në Fanar, me pjesëmarrjen në Liturgjinë e përbashkët Hyjnore të të Dielës së të Gjithë Shenjtorëve.

Në orën 08:10, Fortlumtura u nis nga hoteli drejt Patriarkanës, i shoqëruar nga Mitropoliti i Dyzetë Kishave (Σαράντα Εκκλησιών), hirësia e tij Andrea, dhe dhjaku patriarkal, Fotios, përfaqësues i oborrit të shenjtë patriarkal.

Në orën 08:30, në kishën historike të Shën Gjergjit, Kryepiskopi Joan bashkëkryesoi Liturgjinë Hyjnore me hierarkë të pranishëm të Patriarkanës, në një atmosferë të ngrohtë liturgjike dhe uniteti shpirtëror. Në përfundim të shërbesës u shkëmbyen përshëndetje dhe dhurata simbolike në naos, si shenjë dashurie vëllazërore dhe mirënjohjeje të ndërsjellë.

Në orën 14:00, në nder të Fortlumturisë së Tij, Patriarkana Ekumenike shtroi një drekë në restorantin “Halat by Divan”, në zonën historike të Piri Pashës. Në drekë morën pjesë Tërëshenjtëria e tij, Patriarku Ekumenik, z. Vartholome, Mitropoliti i Myrës, hirësia e tij Krisostomos, Eklesiarku i Madh, si dhe personalitete të tjera të larta kishtare.

Kjo ditë kulmoi vizitën historike të Kryepiskopit Joan në selinë e Patriarkanës Ekumenike, duke lënë gjurmë të forta bashkëpunimi, dashurie dhe respekti të ndërsjellë ndërmjet dy kishave motra.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)